

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 4688 Rep.

Nr. 146 Kol.



AKT I TRANSFERIMIT TE PRONESISE SE AKSIONEVE

Ne Tirane, sot me date 30 Qershor 2005, perpara meje noterit te Dhomes se Notereve Tirane u paraqiten:

Shitesit: **Funds der Republik von Kosovo e.V. (Germany)**, fond i krijuar e ekzistues ne baze te legjislacionit gjerman, i regjistruar ne Regjistrin e Gjykates se Neu-Ulm, Gjermani, me nr. VR 753 date 07.08.1993, me seli ne adresen: Weissenhorn, Buchenweg 7, 89264, Gjermani, me perfaqesues Z. Bujar Bukoshi, lindur ne Shuareke, Kosove, me 13.05.1947, mbajtes i pasaportes nr. (UNK) K0098424, banues ne Prishtine, Rruga e Sharrit, 19 A;

Dhe

Bleresit : **Banca Popolare Pugliese S.c.a.r.l.**, shoqeri kooperative me pergjegjesi te kufizuar e krijuar ne baze te legjislacionit te Republikes se Italise dhe regjistruar ne Dhomen e Tregtise ne Lecce (Itali) me nr. 02848590754 me date 01.07.1994, me seli ne adresen: Via Provinciale Matino no. 5, 73052 Parabita (LE), Itali, i perfaqesuar nga Z. Giancarlo Stasi, shtetas italian, lindur ne Rome (Itali) me 14.01.1947 dhe Z. Mauro Buscicchio, shtetas italian i lindur ne Lecce (Itali) me 01.11.1959;

dhe

Z. Francesco Mariano Mariano, shtetas italian, i lindur ne Lecce (Itali) me 03.06.1971, mbajtes i pasaportes nr. 1991798, banues ne adresen: Piazza S. Oronzo nr. 33, 73100 Lecce (LE), Itali;

Perfaqesuesit e Shitesit dhe Bleresve, per identitetin e te cileve une Noteri mora dijeni nga dokumentet qe me paraqiten, jane madhore e gezojne zotesi te plote jurdike per te vepruar.

Faqe 1 nga 4



Palet e mesiperme me vullnetin e tyre te plote e te lire me deklaruan sa me poshte:

KLAUZOLA HYRESE

MEQENESE, Shitesi eshte aksionari i vetem pronar i 1.000 aksioneve ("**Aksionet**") te kapitalit te **Dardania Bank Sha**, nje banke e organizuar ne formen e nje shoqerie aksionare ne baze te legjislacionit te Republikes se Shqiperise, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me vendimin nr. 8027, date 16.11.1993 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, me seli ne adresen Bulevardi Zogu I, P. 13K, Tirane, Shqiperi (me poshte quajtur "**Banka**"), me nje kapital te nenshkruar prej 5.000.000 US\$ (ose ekuivalenti i tij ne shumen 700.000.000 Leke ne daten 24.10.2001), i ndare ne 1.000 aksione me vlere nominale 5.000 US\$ secila te shlyera plotesisht; dhe


MEQENESE, Bleresit kane rene dakord te blejne nga Shitesi keto aksione dhe Shitesi ka rene dakord me Bleresit per t'i shitur keto aksione sipas kushteve te parashikuara ne Kontraten e Shit - Blerjes se Aksioneve te lidhur midis Shitesit dhe Bleresve ne date 17 Mars 2005 ("**Kontrata e Shit - Blerjes se Aksioneve**"); dhe

MEQENESE, Banka e Shqiperise, me vendimin nr. 47, date 13.06.2005 te Keshillit Mbikqyres, ka miratuar te gjitha transferimet e meparshme te aksioneve te Bankes duke perfshire dhe transferimin e fundit nepermjet te cilit Shitesi eshte shnderruar ne aksionarin e vetem te Bankes; dhe

MEQENESE, Banka e Shqiperise, me vendimin nr. 48, date 13.06.2005 te Keshillit Mbikqyres, ka miratuar blerjen e Aksioneve nga Bleresit, sipas kerkesave te legjislacionit shqiptar.

PER KETO ARSYE, duke patur parasysh marreveshjet e ndersjellta ne Kontraten per Shit - Blerjen e Aksioneve, dhe me qellim realizimin e transferimit te titullit te pronesise mbi Aksionet nga Shitesi te Bleresit, palet bien dakort per sa me poshte vijon:

Faqe 2 nga 4



1. TRANSFERIMI I AKSIONEVE

(i) Ne baze te kushteve dhe dispozitave te Kontrates per Shit - Blerjen e Aksioneve, Shitesi nepermjet ketij akti shet dhe transferon ne favor te Bleresve titullin e pronesise mbi Aksionet, dhe Bleresit pranojne keto Aksione, sipas kushteve te percaktuara ne Kontraten per Shit - Blerjen e Aksioneve.

(ii) Me nenshkrimin e ketij Akti, Bleresit behen pronare te Aksioneve te zoteruara nga Shitesi, sipas raporteve te meposhtme:

- a) Z. Francesco Mariano Mariano, zoterues i 950 aksioneve ose 95 % te kapitalit te Bankes;
- b) Banca Popolare Pugliese S.c.a.r.l, zoteruese e 50 aksioneve ose 5 % te kapitalit te Bankes.

(iii) Shitesi, nepermjet ketij akti, autorizon regjistrimin e transferimit te Aksioneve ne Regjistrin Tregtar Shqiptar, ne emrin dhe pronesine e Bleresve duke pasqyruar raportet e parashikuara ne paragrafin (ii) te nenit 1.

2. PAGIMI I ÇMIMIT TE SHITJES

Vlera e pergjithshme (Çmimi i Shitjes) qe Bleresit detyrohen t'i paguajne Shitesit e percaktuar sipas nenit 4 te Kontrates per Shit - Blerjen e Aksioneve te lidhur midis Shitesit dhe Bleresve ne date 17 Mars 2005 eshte EUR 4.820.000,00 nga e cila shuma EUR 805.000,00 perdoret per te kompensuar detyrimin e Shitesit ndaj Bankes. Bleresit kane transferuar plotesisht shumen EUR 4.015.000,00 qe perben Çmimin e Shitjes pas zbritjes se detyrimit te siperpermendur te Shitesit (EUR 805.000,00) ne nje llogari bankare duke e bllokuar kete shume ne favor te Shitesit dhe Shitesi nepermjet ketij akti deklaroi se kjo shume eshte derdhur dhe bllokuar ne favor te tij ne llogarine e permendur me lart.

3. AKSIONET

(i) Shitesi eshte pronari i ligjshem i Aksioneve, te cilat jane te lira dhe pa asnje barre apo detyrim tjeter.

(ii) Nuk ekziston asnje garanci, e drejte apo ndonje marreveshje tjeter per shitjen e aksioneve, detyrim i cfareddolloj natyre tjeter ne lidhje me keto aksione ne favor te te treteve.

4. DISPOZITA TE PERGJITHSHME





Ky akt perben dokumentin e transferimit te titullit te pronesise se Aksioneve nga Shitesi te Bleresit. Ky akt hartohet ne 3 kopje ne gjuhen angleze dhe 5 (kopje) kopje ne gjuhen shqipe me te njejten vlere secila.


* * *

Une Noteri, u lexoj me ze te larte sa me siper perfaqesuesve te paleve. Meqenese perfaqesuesit e paleve nuk dine shqip, gjithcka iu perkthye ne gjuhen angleze nga perkthyesja Znj. Darinka Piqani, e njohur prej meje Noterit dhe e pranuar nga palet.

Perfaqesuesit e te dyja paleve me deklaruan se kuptuan gjithcka dhe se gjithe sa me siper perputhet plotesisht me theniet e tyre, dhe per rrjedhoje nenshkruajne rregullisht kete akt ne pranine time.

Une Noteri vertetoj kete akt nepermjet nenshkrimit e vules time sipas ligjit ne fuqi.

Shitesi Per: Funds der Republik von Kosovo (Germany)  Z. Bujar Bukoshi	Bleresit: Per: BANCA POPOLARE PUGLIESE S.C.A.R.L.  GIANCARLO STASI Z. Giancarlo Stasi MAURO BUSCICCHIO  Z. Mauro Buscicchio FRANCESCO MARIANO MARIANO  Z. Francesco Mariano Mariano
---	---

Perkthyes
Darinka Piqani

Znj. Darinka Piqani

Noteri Publik
